

LAVDIM MUSAJ
Auditues Ligjor



Adresa
L. "Çlirimi" Rr. "Sul Misiri" Nr 104
tel 05452027 mobil 0698418133
E-mail: aniladimusaj@hotmail.com

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

Mbi Pasqyrën Financiare të
Kapitaleve të Veta të Shoqërisë për
qëllim të zmadhimit të kapitalit të
nënshkruar

«Eltex» sh.p.k.

Për periudhën e mbyllur më
31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

I. RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

II. PASQYRA FINACIARE E KAPITALEVE TË VETA TË
SHOQËRISË, PËR QËLLIM TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË NËNSHKRUAR.

III. SHËNIME MBI PASQYRAT FINACIARE

1. Të dhëna të Përgjithshme mbi shoqërinë.
2. Kapitallet e Veta të Shoqërisë.
3. Përmbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabël të vlerësimit.



LAVDIM MUSAJ
EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

Adresa
L. "Çlirimi" Rr. "Sul Misiri" Nr.104
tel 05452027 mobil 0698418133
E-mail: anilaladimusaj@hotmail.com

Raport i Audituesit Ligjor
Mbi Auditimin e Pasqyrës Finaciare të Kapitaleve të Veta për
qëllim të zmadhimit të kapitalit aksionar

"Eltex" sh.p.k.

Drejtuar:
ORTAKËVE TË SHOQËRISË

Me vendimin e asamblesë së ortakëve nr. 3 datë 14.08.2017 me objekt zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, mu kërkua të ekspertoj vërtetësinë dhe rregullshmërinë e shumave të kapitaleve të veta, që do të përdoren për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Eltex" sh.p.k.

Ne kemi audituar "Pasqyrën Finaciare të Kapitaleve të Veta", për qëllim të zmadhimit të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë "Eltex" sh.p.k. për periudhën ushtrimore të mbyllur më 31 dhjetor 2016. Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtimit të shoqërisë. Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin e kryer, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra finaciare.

Ne e kryem auditimin në pajtim me standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që të planifikohet dhe të kryhet auditimi për të marrë sigurinë e arsyeshme, që pasqyrat finaciare nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin: ekzaminimin mbi bazën e testeve të evidences që mbështet shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat finaciare. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave finaciare. Ne besojme se auditimi jep një bazë të arsyshme për opinionin tonë.

Për mendimin tonë, Pasqyra Finaciare e Kapitaleve të Veta, për qëllim të zmadhimit të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë, jep një pasqyrim real dhe të vërtetë të bilanceve të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31 dhjetor 2016. Ato janë në përputhje me dokumentat dhe regjistrimet kontabël të shoqërisë. Ato mund të përdoren nga ana e ortakëve për zmadhimin e kapitalit të saj.

Me respekt
Lavdim Musaj
Auditues Ligjor

Elbasan, më 14 gusht 2017



**Pasqyra financiare e kapitaleve te veta të shoqërisë
për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar**

Për periudhën ushtrimore të mbyllur më 31.12.2016

Fitimet e pa shpërndara të shoqërisë të shoqërisë	Totali i kapitaleve të veta	Shumat që do të përdoren për rritjen e kapiatlit
Kapitali i Nënshkruar në QKB	100,000	
Paraqitur në pasiv të bilancit si kapital i nënshkruar fitime të bartura plus	74,708,850	74,708,850
Kaptali i nënshkruar i paraqitur në pasiv të bilancit:	74,808,850	
Rezervat Ligjore	-	-
Rezervat Statutore		
Rezeva të tjera		-
Fitimet e mbartura nga viti 2015	11,580,527	11,580,527
Fitimi neto vitit 2016	7,071,487	7,071,487
Lehtësi tatimore të mbartura		-
Totali i rezervave dhe fitimeve	93,460,864	93,360,864

Kontributi i ortakëve për zmadhimin e kapitalit		-
--	--	---

Llogaritjet për zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë

Kapitali i nënshkruar ekzistues në QKB	=	100,000
Gabim në paraqitjen në bilanc (duhej paraqitur fitim i bartur)	-	74,708,850
Shtesa e Kapitalit Dhjetor 2016 nga fitimet e pa shpërndara dhe rezervat	+	93,360,864
Nga detyrimi që shoqëria u ka ortakëve	+	0
Detyrim për tu derdhur nga ortakët në llogaritë bankare të firmës	+	0
Kapitali i mundshëm i shoqërisë për t'u bërë	=	93,460,864
Kapitali i vendosur nga asambleja me vendim nr 3, datë 24.07.2017		93,460,864
Numri i pjesëve në kapitalin themeltar	:	2
Vlera Nominale e një pjese	=	46,730,432
% që zotërojnë ortakët në kapital:		
Oltion Asllani		50%
Arben Asllani		50%

AUDITUES LIGJOR

Lavdim Musaj





1. Të Dhëna të Përgjithshme

Shoqëria "Eltex" sh.p.k. është krijuar më 18 tetor 2007 me kapital fillestar 100'000 lekë.

Administrator i kësaj shoqërie janë zotërinjtë Oltion Asllani dhe Arben Asllani dhe ortakë të vetëm të saj janë po këta të dy me zotërim prej nga 50% të kapitalit fillestar.

Veprimtaria e saj është rregulluar sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr.9901 dt. 14.04.2008

"Për shoqëritë tregtare" si dhe nga statuti i saj.

Selia e shoqërisë është në rrethin e Elbasanit, komuna Labinot-Fushë

Ajo është regjistruar pranë organeve tatimore të rrethit Elbasan me NIPT K73417204D

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është aktiviteti me fashon

Lënda e parë është e porositësit nga italia, (fille leshi), dhe eksportohet produkti triko leshi.

Faturohet dhe eksportohet vetëm vlera e shtuar, pasi lënda e parë rikthehet në origjinë në përbërje të produktit

Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të zgjasë më shumë se 10 vjet.

2. Kapitallet e Veta

Pë realizimin e aktivitetit të saj shoqëria ka një kapital prej 100'000 lekësh, sipas QKB-së.

Bazuar mbi një ekspertizë dhe vendim asambleje për pasqyrat financiare të vitit 2014, në pasqyrat financiare të vitit 2015 kapitali themeltar është paraqitur plus 74'708'850 lekë, kjo e përbërë 100% nga fitimet e bartuara

Paraqitja në bilanc është e rregullt sipas sa më sipër, pavarësisht se nuk është pasqyruar në QKB Pavarësisht vendosjes në rubrika, nën zërin "kapitallet e veta" në pasiv të bilancit, totali është i saktë.

Na rezulton: 74'708'850 lekë fitimet në vitet ushtrimore 2007-2014 + 11'580'527 lekësh fitim në vitin ushtrimor 2015 + fitimi i vitit ushtrimor 2016 prej 7'071'487 lekësh = 93'460'864 lekë

Duke qenë se ortakët kanë vendosur të përdorin pasurinë e vet për rritjen e kapitalit të shoqërisë, m'u kërkua nga ana e tyre të ekspertoj vërtetësinë dhe rregullshmërinë e shumave që do të përdoren për zmadhim të kapitalit.



3. POLITIKAT KONTABËL PËR PASQYRIMIN E KAPITALEVE TË VETA NË BILANC

Si parantezë për sa më poshtë, për sistem referimi si kapital të nënshkruar nuk kam marrë zërin "kapitali i nënshkruar" në pasiv të bilancit por ekstratin historik në QKB-së prej 100'000 lekësh.

a) Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, (SKK).

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase Lekë (ALL).

b) Rezervat

Shoqëria nuk disponon rezerva ligjore

c) Fitime të viteve të mbartura

Shoqëria zotëron fitime të bartura në vlerën lekë: 86,289,376.98

d) Fitime e humbje të vitit ushtrimor

Për vitin 2016 shoqëria ka një fitim prej lekë: 7,071,487.42

Në përfundim, nga shqyrtimi i bilancit financiar të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 vërtetohet si vijon:

1. Aktive afatgjata	60,703,958.50
2. Aktive afatshkurtëra	90,260,516.01
Nga këto	
Gjendja e inventarit	
Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit	84,088,501.23
Likuiditete	6,172,014.78
3. Të tjera të drejta të arkëtueshme	18,351,180.45
Shuma e aktiveve (asetet)	169,315,654.96
Zbriten detyrimet ndaj të tretëve	75,854,790.10
Të pagueshme ndaj furnitorëve	
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore:	5,956,708.52
Të pagueshme ndaj shtetit për TAP, TVSH, T. fitimi ejt	1,266,102.96
Detyrime afatgjata të tjera të pagueshme	17,914,415.98
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	50,717,562.64
Diferenca (e barabartë me kapitalet e veta)	93,460,864.86

Pra, mundësia për rritjen e kapitalit të shoqërisë, duke përdorur fitimet e bartura, fitimin e ushtrimit 2010 dhe rezervat paraqitet:

Kapitali i nënshkruar ekzistues	100,000.00
Nga rezervat	-
Nga fitimet e viteve 2015 dhe 2016:	18,652,014.53
Nga fitimet e bartura të paraqitura si kapital i nënshkruar në pasiv të bilancit	74,708,849.87
Shuma	93,460,864.40

Pra, ortakët, duke përdorur fitimet e bartura, fitimin e ushtrimit, si dhe rezervat, mund ta rrisin kapitalin aksionar deri në shumën që ata kanë vendosur me vendimin nr 3, datë 22.07.2017 për lekë:

93,460,864.40

AUDITUES LIGJOR

Lavdim Musaj

